Lezhë, më 27.07.2023

# PROCESVERBAL

I mbajtur sot, në dt. 27.07.2023, në orën 13:00, në sallën e Bibliotekës "At Gjergj Fishta" Lezhë, mbi mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Lezhë.
Mbledhja u hap nga kryetari, z. Ndue Luli, i cili lexoi rendin e ditës, si dhe një projekt vendim shtesë "Për dhënien e dakordësisë për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor kombëtar të sipërfaqes pyjore në pronësi të z. P.P, brenda territorit të Bashkisë Lezhë", si dhe 3 raste dorëheqjesh këshilltarësh.
Më pas ai hodhi në votim rendin e ditës me shtesat, që u miratua me 24 vota pro
Nuk votuan 4 këshilltarë.

- Ndue Luli: Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës që është projekt-vendim "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-30 Qershor 2023".
Është diskutuar dhe sjell në komisionin e Ekonomisë.
Ka ndonjë mendim?
I japim fjalën kryetarit të komisionit.
- Agostin Marku: Në emër të komisionit të Ekonomisë dua të falenderoj së pari pjesën dërrmuese të anëtarëve të komisionit për seriozitetin por edhe përfaqësuesit e bashkisë që morën pjesë dhe e vlerësuan seriozisht jo vetëm këtë p/vendim por të gjitha p/vendimet që mori në analizë Komisioni i Ekonomisë. Uroj që në të ardhmen të jetë

Ky bashkëpunim për t'i shërbyer sa më mirë vendimmarrjes, për të qenë sa më cilësore dhe në shërbim të qytetarëve.

Komisioni i Ekonomisë dhe në bazë të detyrës që ne kemi VKB, zgjodhi sekretarin, i cili është Klevis Bezhi, dhe është dakord në parim për të kaluar ky p/vendim pasi e sheh të bazuar në ligj. Është një p/vendim që i shërben qytetarëve në nevojë. Faleminderit.

- Ndue Luli: Mendim tjetër?
- Alfrida Marku: Jo votim sot, por asnjëherë nuk do debatojmë për ndihmën ekonomike.

Ndihma ekonomike është një mundësi për t'i fuqizuar këtej kategorie, për gradualisht të jetë pjesë dhe e tregut të punës. Ajo që më shqetëson dhe nuk më bind në këto lista është fakti që nuk ka një shpërndarje të arsyeshme sa i përket 6%, në të gjitha njësitë administrative.

Kërkoj vëmendjen e njësia dhe të D. Shërbimit Social për të kemi një shpërndarje të balancuar.

- Ermal Pacaj (ZV/kryetar i Bashkisë) – 6%-shi është në bazë të kritereve. Pra ka një logjikë krejt tjetër. Ligji nuk e parashikon që të bëhet në bazë të njësive, por në bazë të kritereve
- Enida Molla (ZV/kryetare e Bashkisë) – Në bazë të aplikimeve që ne kemi, sipas pikëzimit, sistemi bën dhe përzgjedhjen.

— Ndre Luli: E hedhim në votim projekt vendimin.
Miratohet me 28 vota PRO.
0 kundra, 0 abstenim.
Kalojmë te pika 2 e rendit të ditës që është
projekt vendim "Për një shtesë në vendimin nr. 4,
dt. 31.01.2023 "Për miratimin e listës së të
pastrehëve që përfitojnë subvencionim të qirasë
për vitin 2023"".
Komisioni i Ekonomisë ka përsëri fjalën.
— Agostin Marku: Edhe për këtë projvendim, komisioni
i Ekonomisë u shpreh dakord, pasi e sheh të
bazuar në ligj. Kemi vetëm një sugjerim për drejtorinë
përkatëse. Kur ka raste të tilla, të përpiqen që
t'i sjellin në grup, që të krijojmë një politikë të
qartë në këtë drejtim. Faleminderit.
— Ndre Luli: Mendim tjetër?
— Alfrida Marku: E kam lexuar relacionin. Kjo është
një ndihmë e përkohshme ndaj një shtetasi në kushte
të vështira ekonomike. Meqë këtu kemi dhe
përfaqësuesit e bashkisë, meqë po flasim për strehimin,
unë dua të sjell në vëmendje, problemin e 10
familjeve të pallatit 47, këtu në pendës të
qytetit, i njohur ndryshe si pallati Bur, i cili
është dëmtuar nga tërmeti i vitit 2019. Që
kur është shembur, nuk është bërë asgjë
konkrete për rindërtimin e tij.
Çfarë masash ka marrë bashkia për të

zgjidhur këtë problem emergjent për këto 10 familje, shtuar dhe faktin që fondet për rindërtimin janë siguruar, sepse këta po diskriminohen, po u shkaktohet dëm moral. Nuk mund të jetë justifikim, arsyetimi se u paguhet qeraja. Shkurt dhe prerë, në çfarë faze është procesi për rindërtimin e këtij objekti?

Ermal Pacaj: Sa i përket pallatit të BKT, në fakt, po, ashtu është.
Ne kemi një akt-marrëveshje me shoqërinë bamirëse "Firdeus", me të cilën kemi një efekt për të bashkëpunuar për ta ndërtuar këtë pallat.
Të 10 familjet, që nga dita e parë janë asistuar me strehim, duke filluar me strehimin provizor në fillim te Rafaelo dhe duke vazhduar me bonusin e qerasë.
Bashkia Lezhë është në masën 90% në realizimin e procesit të rindërtimit.
Po, është vonuar pak rindërtimi i pallatit BKT, por është vonuar në bazë të marrëveshjes që ne kemi për rindërtimin e tij. Besoj dhe shpresoj që do kemi një zgjidhje definitive shumë të shpejtë.

— Agostin Marku: Kam diçka për procedurë.
Ne prandaj kemi thënë të ngrihen e të funksionojnë komisionet. Të vijmë këtu dhe të jemi produktivë për çdo pikë të rendit të ditës.

Çdo këshilltar ka të drejtë të shtrojë një problem sepse ka një pikë "Të ndryshme". Mund të kërkojë interpelancë për strehimin, për tërmetin, për gjithçka.
Jemi duke i dhënë një të vobekti personel për të pastrehë. Bëjmë politikë për tërmetin.

— **Erin Ndreca**: Në emër të grupit më të madh të mazhorancës, e kam thënë dhe herën tjetër z. kryetar, të lutem të respektohet koha e fjalës. Kërkoj që të zbatohet me përpikmëri rregullorja duke parë dhe ngarkesën që ka rendi i ditës.

— **Ndue Luli**: E hedhim në votim projektvendimin.
Miratohet me 28 vota PRO,
0 KUNDRA, 0 abstenim.
Kalojmë te pika ~~e tretë~~ e rendit të ditës që është projektvendim "Për një ndryshim në VKB nr. 13, datë 21.02.2023 "Për miratimin e kërkesës për kalimin në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale tek Bashkia Lezhë, të objektit Ish Materniteti Lezhë, pasuria me nr. 3/51, 3/52, Zona kadastrale 8632""
Përsëri ka fjalën Komisioni i Ekonomisë.

— **Agostin Marku**: Më falni që në këtë mbledhje, për të gjitha pikat e rendit të ditës, në emër të komisionit po e marr fjalën unë, por duke u konsoliduar komisioni do i ndajmë si detyre

te çdo anëtar dhe pse si komision ka peshën kryesore se i përket këtyre problemeve. Komisioni e shqyrtoi me përgjegjshmëri këtë vendim. Falenderoj bashkinë se ka pasur interesim të marrë këtë objekt shumë të rëndësishëm, duke krijuar mundësinë që dhe institucionet e bashkisë të sistemohen, pasi shumë prej tyre janë në objekte me qera, që është kosto e madhe administrative për të gjitha institucionet shtetërore. Kjo është një procedurë e filluar që me këshillin e mëparshëm. Komisioni duke parë përputhshmërinë ligjore, i rekomandon këshillit të Kolonjës për votim.
Faleminderit.

– Ndue Luli: A ka ndonjë mendim tjetër?

– Fluture Gjoni: A ka një dokument, një shkresë nga Ministria e Shëndetësisë? Nëse ka, ju lutem na e bëni me dije.

– Ermal Pacaj: Ne kemi një korrespondencë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe një marrëveshje, ku objekti i maternitetit të vjetër pasi mbeti i lirë pas ndërtimit të maternitetit të ri te spitali, të na vihet në dispozicion për ta administruar. Ne i kemi marrë leje këshillit të Bashkisë, i cili e ka miratuar. dhe pastaj me korrespondencë, Ministria e Shëndetësisë është shprehur që mund të marrim dhe në pronësi. Pra, ne i jemi drejtuar këshillit, që a mund të vazhdojmë

korespondencën me ministrinë, a mund t'ia kërkojmë si pronësi. Ky është pëllimi i p/vendimit.

– Flutura Gjoni: Me dijeninë time, ky objekt është në ASHK në proces legalizimi.

– Ermal Pacaj: Materniteti është objekt me çertifikatë pronësie, në pronësi të Ministrisë së Shëndetësisë.

– Agostin Marku: Unë e sqarova. Është një procedurë e filluar me këshillin e mëparshëm. Ky është miratimi i fundit që japim ne mbi bazën e korespondencës midis Bashkisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Kur është miratuar herën e parë nga këshilli i mëparshëm kanë pasur të gjitha këto dokumente që thoni ju.

– Flutura Gjoni: Jam pro në parim.

– Ndue Luli: Atëherë kush është dakord me p/vendimin?

Miratohet me 27 vota pro.

Flutura Gjoni abstenim.

Kalojmë te pika 4 e rendit të ditës që është projekt vendim "Për një shtesë e ndryshim në buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2023 dhe përdorim të fondit të akorduar për rritjen e pagave".

Fjalën e ka kryetari i Komisionit të Ekonomisë.

– Agostin Marku: Komisioni e shqyrtoi këtë p/vendim. Është i përgatitur me kohë. Për efekt të zgjedhjeve, që mos të merret për abuzim me

fondet e bashkisë, edhe pse këto fonde janë të deleguara, është menduar të sillet në mbledhje më të parë të këshillit pas konstituimit të organeve organizative të këshillit.
E gjejmë në përputhje me ligjin. Shumat janë që sa janë të deleguara nga ministria përkatëse dhe duhet te kalojmë në mënyrë që bashkia të operojë dhe kjo sistemë e pagesave të shkojë se me shpejt te secili pronarës. Faleminderit.

— Ndue Luli: Meqë nuk ka mendime të tjera e kalojmë p/vendimin në votim.
Miratohet me 28 vota pro, 0 kundra, 0 abstenim
Kalojmë te pika 5 e rendit të ditës që është projekt vendim "Për përdorimin e Fondit të Kontingjencës, për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara në buxhetin e vitit 2023".
Komisioni i Ekonomisë përsëri ka fjalën.

— Agostin Marku: Është një fond me një vlerë 50.000 lekë, për shpenzime noteriale, proceduriale, për krijimin e hapësirave për të filluar procedurat për rrugën Shëngjin-Baks-Rrjoll.

— Ermal Pacaj: Komisioni që ka mbyllur procedurën për shpronësimet e asaj rruge ka një komision prej 50000 lekësh, që duhet të paguhen nga Bashkia Lezhë.

— Ndue Luli: E hedhim p/vendimin në votim.
Miratohet me 28 vota.
zero kundra dhe zero abstenim.

Erdhi Kryetari i Bashkisë z. Pjerin Ndreu.

– Ndue Lufi: Kalojmë te projekti vendimi tjetër (shtesë) "Për dhënien e dakordësisë për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor kombëtar të sipërfaqes pyjore në pronësi të z. P. P., brenda territorit të Bashkisë Lezhë".

→ Erdhi këshilltarja Justina Gjushi.

→ Kryetari i dha fjalën Kryetarit të Bashkisë për të dhënë sqarime në lidhje me p/vendimin.

– Pjerin Ndreu: Përshëndetje të gjithëve.
Ky është një p/vendim që vjen për shkak të një projekti të aplikuar që ka marrë miratimin gati përfundimtar, për ngritjen e një resorti por pavarësisht se P. P. e ka pronë të vetën, na duhet një procedurë këshilli për heqjen nga fondi pyjor. Në atë zonë ka një fluks aplikimesh të resorteve me standarte nga më të mirat, duke futur dhe brand-e të ndryshme. Është interesi i zhvillimit por dhe interesi ekonomik i bashkisë për shkak të mirëmenaxhimit duke pasur parasysh që po bëjmë 4 vjet pa taksë infrastrukture. Vetëm 3 leje ndërtimi ka dhënë bashkia për 4 vjet, për shkak të bllokimit nga veriu. Është një e ardhur që na ka munguar.

– Ndue Lufi: Fjalën e ka komisioni

— Agostin Marku: Komisioni e shqyrtoi dhe uron të ketë sa më shumë raste të tilla sepse do ketë ndikim të jashtëzakonshëm në shtimin e të ardhurave të bashkisë si rezultat i marrjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë, por resorte të tilla do kenë ndikim dhe në fushën e turizmit. Pra jemi dakord për të kaluar dhe e shohim në përputhje me fitimet aktet ligjore në fuqi. Faleminderit.

— Ndue Luli: Kush është dakord me p/vendimin?

Miratohet me 27 vota pro.

Alfrida Marku nuk votoi

Flutura Gjeni abstenoi.

Kalojmë te projekt vendimi që është në pikën 6 të rendit të ditës "Për disa ndryshime në vendimin e këshillit të Bashkisë Lezhë nr. 133, datë 20.12.2022 "Për miratimin e pagave të administratës së bashkisë, të njësive administrative, të institucioneve të varësisë, të punonjësve të njësive mbështetëse, të masës së shpërblimit mujor të këshilltarëve dhe kryetarëve të fshatrave për vitin 2023, i ndryshuar".

Fjalën e ka komisioni i Ekonomisë.

— Agostin Marku: Është çështja që ka harxhuar më shumë kohë për komisionin por dhe për administratën e bashkisë. Gjej rastin t'i falenderoj për gadishmërinë për një ndryshim pothuajse

ndërmjetësor të projektit që kishin depozituar. Ka të bëjë me çështje thjeshtë të konceptimit të ligjit, me qëllim jo thjesht dhe nga shtesë që u paraqit nga bashkia, kjo nuk mund të jetë shtesë sepse ka ndryshuar komplet konceptimi mbi pagat dhe shpërblimet me ligjin e ri që ka dalë në maj 2023 por dhe me vendimet përkatëse të qeverisë që janë sipas fushave të caktuara të administratës shtetërore dhe vendore, për këtë të fundit është vendimi nr. 328. Prandaj si rezultat i kësaj kërkohej që p/vendimi të ishte totalisht i ri dhe të binte poshtë vendimi aktual për pagat e bashkisë. Është përpjekur që të ruhet hierarkia e pagave. Kemi bërë disa rregullime të vogla dhe në atë që kemi depozituar sot në emër të komisionit të Ekonomisë me dakordësinë e plotë të bashkisë. Kemi marrë dakordësinë e kryetarit dhe është shumë i përkushtuar që ndryshime të bëhen dhe në fund të vitit me buxhetin e bashkisë për vitin e ardhshëm dhe për sistemin e pagave të bëhet përsëri rregullim, në mënyrë që ne të kemi një sistem pagash të shëndoshë, cilësor, që të nxisë administratën të punojë sa më mirë. Kërkoj në emër të komisionit të Ekonomisë që të kalojmë atë projekt-vendim që ju kemi paraqitur ne sot, që është në përputhje me

ligjin e ri dhe me VKM-në e re, për të cilin është dakordësuar me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore por dhe me Drejtorinë e Financës.
Faleminderit.

– <u>Alfrida Marku</u>: Në parim nuk jam kundër rritjes së pagave por konstatoj që është një p/vendim që nuk vjen nga një proces analitik i plotë. Së pari, në përgatitjen e tij, përveç Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Drejtorisë Juridike duhej të ishin dhe Drejtoria e të ardhurave vendore dhe Drejtoria e Financës. Është analizuar shkaku për rritjen, pra VKM-ja, por nuk është analizuar pasoja. Dhe pyetja ime është: Sa është pesha financiare që sjell në buxhetin e bashkisë rritja e pagave të administratës sipas p/vendimit që keni propozuar. Nga ana tjetër, nëse i referohemi VKM-së 328, dt. 31.05.2023, për secilin funksion përcaktohet një marzh i caktuar minimum dhe maksimum dhe ju keni përcaktuar nivelin maksimal për rritjen e pagave ose në disa raste afër kufirit maksimal, kryesisht për pagat e funksioneve më të larta. Pra, nëse flitet të rrisim pagat, që asnjëri nuk është kundër, të rrisim pagat më të ulta. Unë propozoj që ky p/vendim, duke parë dhe situatën financiare të Bashkisë Lezhë, referuar Raportit të Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit për 4-mujorin e parë 2023, (RMZB)

të ristikohet në koordinim me Drejtorinë e të ardhurave vendore dhe Drejtorinë e Financës.
Në parim nuk jam kundër rritjes së pagave, por gjendja financiare e bashkisë nuk është e qëndrueshme dhe rritja e pagave, sikundër nuk është urgjente, nuk mund të jetë prioritet.
Do jap disa argumente. Duke iu referuar R.M.Z.B për 4-mujorin e parë 2023, Bashkia Lezhë ka dështuar të mbledhë të ardhurat vendore duke arritur një shifër jo më shumë se 32 % të asaj që kishte planifikuar. Së dyti, po t'i referohemi një projekt vendimi që është në votëdin në rendin e ditës, për disa ndryshime në buxhet, pamundësia financiare e detyron bashkinë që të heqë dorë nga projekti për kaldajën e gjimnazit dhe projektin e vendosjes së kamerave të sigurisë për sheshet e qytetit.
- Ndue Luli: Të lëmë kur t'i vijë radha.
- Alfrida Marku: Unë po arsyetoj. Janë 2 projekte prioritare nga të cilat hiqet dorë dhe prezantohen këto si emergjente rritjen e pagave.
Bashkia ka dështuar në mbledhjen e të ardhurave në 4-mujorin e parë të vitit që përkon dhe me periudhën zgjedhore, pra pëllimisht nuk janë mbledhur të ardhurat në funksion zgjedhore.
Pyetja për të përmbledhur është: Sa është pesha në buxhet e vendimit që ju propozoni për rritjen e pagave? (Mujore dhe vjetore)

— Ndue Luli: E ka fjalën kryetari i komisionit të Ekonomisë.

— Agostin Marku: Unë isha shumë i qartë kur fola për p/vendimin, madje që të ishim sa më transparentë bëmë dhe ato rregullimet dhe Bashkia ra dakord. Për të rritur pagat na na detyron ligji dhe VKM e re., Madje tashti që hyn në fuqi nga 1 prilli. Ne nuk mund ta shtyjmë në pafundësi.
Së dyti, janë marrë të gjitha drejtoritë që u takon të merren me këtë punë: D. Juridike, D. B. Njerëzore, D. Financës. N.p.s ka fushë që s'duhet të merret me politikën e rritjes së pagave, është Drejtoria e Taksave.
Ka një hierarki, ka një pagë minimale, ka një pagë maksimale, dhe këshilli ka të drejtë të përcaktojë pagën midis këtyre dy niveleve dhe paga minimale është rritur në 40000 lekë me VKM. Për pagat e vitit tjetër, kemi rënë dakord edhe me kryetarin e Bashkisë, që të ketë sa më shumë motivim, që të bëhet një studim i hollësishëm dhe të ketë një përmirësim më të madh.
Madje, a bën që pagat t'i bëjmë maksimale për punonjësit e bashkisë, por t'i kërkojmë llogari që të realizojnë detyrat, të realizojnë të ardhurat, të realizojnë shërbimet, të realizojnë investimet strategjike e gjithçka.

— Pjerin Ndreu (kryetari i Bashkisë) – E para, n.p.s flasim për pagat, sa për dijeni të Këshillit,

pagat e punëtorëve janë rritur 3 herë deri tani dhe një herë janë rritur pagat e drejtuesve, pra në raportin 3:1. Kur kemi ardhur ne në Bashki, paga e punëtorëve ka qenë 26000 lekë dhe në atë kohë tatohej paga minimale, që s'bën kund tjetër në Shqipëri dhe ky është fakt në bordero. Pra, p.sh. duhet të bëjmë politikë se kujt i është rritur më shumë paga, e kujt më pak, më shumë i është rritur punëtorëve, që për hir të së vërtetës janë po ata që kam gjetur, unë nuk kam hequr njëri. Gjithsesi, nëse ka diçka për të parë dhe për të përmirësuar në sistemin e pagave në pushtetin lokal, që për hir të së vërtetës ka qenë më i leni mbas dore, në hierarkinë e pagave në vend, ka vend për të rritur, jo për të ulur. Ka të bëjë dhe me kapacitetet që vijnë në punë. Nuk të vjen njeri më me rroga të ulta, dhe ne kemi vështirësi në këtë aspekt. Na ka ndodhur që pas konkurseve na kanë ardhur punonjës që nuk e kanë justifikuar punën ose kanë ikur. Nuk është një gokë, por një stimul që u bëjmë drejtuesve. Në aspektin financiar, Bashkia ka dalë nga zona e kuqe dhe është në zonë jeshile, pavarësisht se ne nuk kemi parë taksën kryesore, taksën e ndikimit në infrastrukturë për 4 vjet rresht. Nuk dua të merrem me të shkuarën

Ne nuk kemi dhënë rrogë kot. E kemi marrë bashkinë nga kolapsi financiar. Brenda këtij viti zerojmë borxhin. Kemi shkurtuar shpenzimet, kemi shkurtuar pagesat. Pra, shikojmë se çfarë mund të përmirësojmë. Duhet të bëhemi bashkë e të gjykojmë me mirësi në shpirt dhe me objektivitet. Ne nuk jemi perfektë. Më përpara, me VKM për ka qenë, i binte që përstruesje e një institucioni qendror merrte më shumë se një drejtori i bashkisë. Këto gjëra kanë ardhur duke u rregulluar. Granti i pavarësisë është 2,4 mln lekë. Bashkia Lezhë është jashtë kolapsit financiar. N.q.s ka një problem me të ardhurat tani, viti buxhetor nuk është mbyllur. Faza e parë e mbledhjes së taksave ne na shkon deri më 31 gusht, për t'i krijuar lehtësi biznesit. Nuk është viti i parë që e bëjmë. E kemi bërë dhe vjet, që nuk ishim në proces elektoral, mund ta verifikoni. Ne bëjmë 2 takime të hapura para fillimit të sezonit turistik me biznesin, shkëmbejmë mendime me ta. Ju thashë dhe njëherë. Nuk ka asgjë perfekte. Por është absurde t'i lidhësh taksat me zgjedhjet.
Faleminderit.

— Alfrida Marku: Z. Ndreu unë të flej të merresh me të kaluarën, por të jesh i sigurt se do të shkojë mundi kot. Unë e përsëris,

ajo që më shqetëson është që pse në 4-mujorin
e parë të këtij viti, bashkia bie në 32 %
të mbledhjes së taksave dhe ngjifton të
Dëshiroj votim një të "taksën e tabelës" është
në shifrën 9%. dhe rrjedhimisht unë them që
është përdorur si mekanizëm në fushatën zgjedhore.

— Ndue Lushi: Meqë nuk ka mendime të tjera,
kush është dakord me projekt-vendimin?
Miratohet me 25 vota PRO
1 votë abstenim (Flutura Gjoni)
3 këshilltarë nuk u shprehën me votë dhe
konkretisht Donika Ndoj, Alfride Marku, Rrok Marku.
Kalojmë te projekt vendimi që është si pikë 7
e rendit të ditës, "Për një ndryshim në vendimin
e KB nr. 120, datë 02.12.2022 "Për miratimin
e PBA-së 2023-2025 dhe Buxhetit të vitit 2023".
Komisioni i Ekonomisë e ka fjalën.

— Agostin Marku: komisioni e ka shqyrtuar, është
dakord të kalojë, e shohim në përputhje me
ligjin.

— Alfride Marku: Me këtë projekt vendim keni
propozuar që të ndryshoni vendimin e mëparshëm
të K.B. që parashikon asfaltimin, ndriçimin e
Parkut të Kulturës. Absolutisht nuk jemi kundër.
por cila është arsyeja që bashkia nuk ka mundësi
financiare për ta zbatuar këtë projekt, duke shtuar
që bashkia hap dorë nga 2 projekte shumë të

rëndësishme për faktin kamerat e sigurisë nëpër shkolla dhe kaldaja në gjimnazin "Hydajet Lezha". Dalim përsëri te një mosmbledhje e të ardhurave.

— Agostin Marku: Ju kërkoj ndjesë sepse unë iu referova pikës tjetër në fakt. Bashkë me komisionin e kulturës e kemi diskutuar këtë çështje. Ne e pamë të arsyeshme që t'i japim okejin për arsye se kemi të bëjmë me një investim gjigand, siç është rikonstruksioni i Pallatit të Kulturës dhe te kësi po vënë në funksionim për çështje ndryshimesh buxhetore, e t'ia shtyjmë afatin e vënies në funksionim vetëm për burokracira, nuk e shoh të arsyeshme dhe Bashkia Lezhë ka bërë shumë mirë që ka bërë transferimin nga zëra të tjerë që nuk i shoh të mundur gjëtë këtej kohe, duke rritur efektivitetin e fondeve

— Pjerin Ndreu: Meqë këtu po tentohet të bëhet politikë, po bëjmë edhe ne pak. Në buxhetin e vitit 2023 ne kishim planifikuar 100 mln lekë të vjetra për Pallatin e Kulturës, mirëpo duke pasë parasysh se është bërë i një standarti shumë të lartë, neve na duhet ta pajisim me komoditetin që meriton dhe na u desh të gjejmë fonde të tjera se 100 mln të vjetra nuk dilnin as për sallën. Jemi detyruar të ndërhyjmë për ta vënë në funksion dhe është një

institucion shumë i rëndësishëm social-kulturor.
Ajo kaldajë na bie në kokë mua dhe kësaj zonjës që flet se të dyja pallat, për 4 vite ato e 4 vite na, nuk kemi qenë të aftë me kuptu bashkë me stafet tona se ajo kaldaja funksionon dhe nuk ka nevojë tani që të blihet e re sepse kemi gjithë mjeshtër për këtë punë i cili ka ardhur e ka ndezur, e ka vënë në punë. Ndërsa kamerat do i bëjmë me donator, ashtu siç kemi bërë shumë gjëra të tjera. Ama, ky pallati i Kulturës i shërben gjithë Lezhës dhe mezi po e presin. Ne kemi vënë një standard, që gjithë grupet teatrore dhe artistike do bëjnë prova aty me zero lekë, mjafton që jeta kulturore-artistike e këtij qyteti të shkojë duke u ngritur.

— Alfons Troshaj (Komisioni i kulturës) - Ne si Komision jemi mbledhur dje. Pallati i Kulturës ka qenë në gjendje të mjerueshme dhe është gjë shumë e mirë që bashkia po merr këtë iniciativë që çdo sallë të jetë efiçiente për fëmijët tanë, për çdo qytetar, për aktivitetet që zhvillohen në qytetin e Lezhës. Në përfundim kishte ca gjëra të pacilësuara mirë dhe patëm drejtorin prezent dhe ramë dakord që ca gjëra të zëvendësohen. (blerjet që do bëhen, tavolina, karrige, foni...) dhe drejtori sot të na i thotë.

– kryetari z. Ndue Luli i dha fjalën z. Renaldo Xhanej, Drejtori i kulturës, i cili dha sqarime në lidhje me p/vendimin.

– kryetari i dha fjalën znj. Flutura Gjoni e cila pohimet nuk ishte kundër por shprehu shqetësimin për zërat e hequr nuk janë në PBA-në 2024-2026 (përveç Kemiçeve për do bëhen me donatorë, sipas sqarimit të kryetarit të bashkisë)

– Pjerin Ndreu: Ne kemi parasysh për këto nuk janë domosdoshmëri sot. Normalisht disa nga këto do futen në PBA-në sërish. Ne do argumentojmë ça do jetë e ça s'do jetë. Sot kemi një problem për është pallati i kulturës. Duhet të kuptojmë ça ndodh me buxhetin. Ne jemi të detyruar për të riperojmë herë pas here. Heqim diçka për nuk është e domosdoshme dhe bëjmë diçka për është më primare. Në shtëpinë tënde nuk e bën dot perfekt. S'ka shanc.

– Erin Ndreca: Ndërhyrje ime nuk do jetë si profesionist pasi këtë detyrë e kanë kemisionet. Më vjen mirë që opozita i lexon me kaq vëmendje p/vendimet, por po t'i kishin lexuar çik më mirë, do t'i kishin realizuar vetë mbase, e jo të linin bashkinë në atë katrahurë siç e kanë lënë. Do të thotë për nuk është qëllimi për të ndihmuar komunitetin por për

të bërë politikë. Mendoj që përgjigjet i morët mjeft të porta në Kalljë me p/vendimin dhe propozoj të vazhdojmë me votimin Kryetar.

- Ndue Luli: E kalojmë p/vendimin në votim.

U miratua me 27 vota PRO.

1 abstenim (Flutura Gjoni)

1 nuk votoi (Alfrida Marku)

Kalojmë te projekt vendimi tjetër që është në pikën 8 të rendit të ditës "Për miratimin e buxhetit faktik të Bashkisë Lezhë për 4-mujorin e parë të vitit 2023".

Kryetari i komisionit të Ekonomisë e ka fjalën.

- z. Agostin Marku shprehu dakordësinë për te kaluar për votim p/vendimin duke vlerësuar Bashkinë Lezhë për performancën pozitive

- Ndue Luli: Meqë nuk ka mendime të tjera e kalojmë p/vendimin në votim.

Miratohet me 24 vota PRO.

Nuk votuan: Rrok Marku, Alfrida Marku, Emanuel Përgjoku, Donika Ndoj, Tonin Jaku.

Kalojmë te projekt vendimi tjetër që është si pikë 9 e rendit të ditës "Për miratimin e PBA-së 2024-2026 të Bashkisë Lezhë (Faza e Parë)".

- U zhvillua debat politik mes z. Erin Ndreca, z. Agostin Marku dhe z. Alfrida Marku.

- z. Ndue Luli i dha fjalën znj. Alfrida Marku

për të folur mbi vendimin.

- Alfrida Marku: A ka zhvilluar bashkia konsultim publik në të gjitha njësitë administrative dhe me të gjitha grupet e interesit në shërbim të konkluzionere për fatën e parë të PBA-së 2024-2026?
- Pjerin Ndreu: Nuk është bërë konsultim publik sepse kemi pasur në fushatë zgjedhore. Që nuk është bërë deri sot, nuk është ndonjë shkelje për t'u evidentuar sepse jemi dhe fazat e tjera.
- Agostin Marku: Është bërë konsultim online por Znj. Marku nuk i pëlqen.
- Debat politik Erin Ndreca - Alfrida Marku.
- U largua këshilltarja Sidorela Kola.
- Agostin Marku: Dua të sqaroj këshillin. Me vendim të KQZ-së, si vit zgjedhor, si fushatë zgjedhore, kemi pasur të ndaluara të gjitha dëgjesat publike. Po të bëheshin, do konsideroheshin konflikt interesi dhe fushatë. Alfrida nuk e di se nuk ka patur kandidat në fushatë.
- Flutura Gjoni: Në lidhje me PBA-në, vihet re që taksat janë rritur 4,2 herë ndërsa tarifat vendore janë 1,6 herë, në krahasim me të 2022-shit. Dhe kjo sipas meje i bie që nuk jemi mirëpërdor me

biznesin, Është parashikuar në vitin 2026 Studimi për përmbytjet. Është imediate për t'u bërë më përpara. Pritat malore, edhe këto në 2026-n. Shpenzimet për investime janë mbajtur pothuajse për të tre vitet në të njëjtin nivel. Ndërkohë që ke rritje të të ardhurave, përse nuk shkojnë ato te rritja e investimeve?

- Xhemal Hoxhia (sp. buxheti bashkisë) - Buxheti i vitit 2024 fillon në 1 janar 2023 duke filluar me vlerësimin e burimeve, duke miratuar prioritetet, duke vazhduar pastaj me tavanet. Këshilli bën dëgjesa, kryetari bën konsultime. Procedoj buxheti kalon në 3 faza, I qershori, kemi ardhur tavanet e fazës së dytë. Kemi edhe mendime të Ministrisë së Ekonomisë dhe financave. Ne jemi ndër bashkitë më të mira për sa i përket përftimit të burimeve në investime.
- Alfrida Mallu: Keni ndërprerë transmetimin live.
- Ndue Lulë: Jemi live.
- Pjerin Ndreu: Jemi live por i ke mbaruar afatet zonjës.
- Erin Ndreca: I ke mbaruar afatet dhe logjike.
- Alfrida Mallu: N.q.s është dikush që nuk i intereson se çfarë thua ti, ajo jam unë. Mbiemri nuk të bën trim.

- Flutura Gjoni: Mendimi im është që në lidhje me përmbytjet dhe pritet mbrojtëse që janë lënë për vitin 2026, të bëhet diçka që të afrohen, pra të rishikohet.
Nuk e kemi për politikë.
- Ndue Luli: Meqë nuk ka mendime të tjera, e kalojmë p/vendimin në votim.
Miratohet me 26 vota PRO.
Alfride Marku nuk votoi.
Flutura Gjoni abstenoi.
Kalojmë te projekt vendimi që është në pikën 10 të rendit të ditës "Për miratimin e tavaneve të shpenzimeve sipas programeve buxhetore për PBA-në 2024-2026 (Faza e Dytë) të Bashkisë Lezhë".
- Agostin Marku: Edhe ky është një p/vendim praktikisht si rasti tjetër. Ne e shohim që është në përputhje me ligjin dhe komisioni është dakord që ta kalojmë për miratim.
- Ndue Luli - Meqë nuk ka diskutime, e kalojmë në votim p/vendimin.
Miratohet me 26 vota PRO.
Nuk votuan Alfride Marku dhe Alfons Trashaj.
Pikat 11 dhe 12 te rendi i ditës janë thjesht për njohje. Materialet i keni pasi nuk janë për vendimmarrje.
Siç ramë dakord në fillim, do marrim

në shqyrtim tre raste dorëheqje këshilltarësh me deklaratë noteriale, Miranda Dodaj, Justina Gjuşi, Xhovana Gjokhilaj.

- Agostin Marku: Një ndërhyrje, anëtarët e këshillit prezent që sa lexuan emrat, nuk kanë të drejtë të votojnë kur diskutohet për emrin e tyre sepse përbën konflikt interesi.
- Ndue Luli: Atëherë, i marrim në shqyrtim një për një emrat:
Kush është dakord për heqjen e mandatit të znj. Miranda Dodaj?
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
Kush është dakord për heqjen e mandatit të znj. Justina Gjuşi?
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë. (Justina Gjuşi nuk votoi)
Kush është dakord për heqjen e mandatit të znj. Xhovana Gjokhilaj?
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
Ju faleminderit.
- Kryetari z. Ndue Luli kaloi te pika "Të ndryshme" ku këshilltarët Alfrida Marku, Alfons Traskaj dhe Donika Ndoj ngritën shqetësimet e tyre dhe morën përgjigje nga z. Pjerin Ndreu - kryetari i Bashkisë.
- Ndue Luli: Kisha diçka dhe unë drejtuar këshilltarëve. Gjetë mundësi dhe e pat mugjit që t'ju dërgojmë rregulloren e strukturave komunitare.

Ta studiojë secili dhe të japë mendime, në mënyrë që në mbledhjen e qershorit të miratojmë rregulloren e strukturave komunitare, gjithashtu të përcaktojmë kalendarin e zgjedhjeve të kryetarëve të fshatrave.
Gjithashtu do ju dërgojmë kodin e Etikës.
Ju falenderoj të gjithëve.

| SEKRETARI | KRYETARI |
| --- | --- |
| FLORIDA ÇUNAJ | NDUE LULI |

SHËNIM: Mbledhja u transmetua live në Facebook në faqen "Këshilli i Bashkisë Lezhë".